

Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Gjenden dy predha në lumin Buna, u pikasën nga italianët me magnet, bllokohet ura e vjetër

Senad Nikshiqi | 07 Shtator, 2021 14:40



Madhësia e tekstit: - +

- Dy predha janë gjetur në ujërat e lumit Buna në qytetin e Shkodrës. Dy predhat janë gjetur në afërsi të urës së vjetër të Bunës brenda në ujë.
- Sipas burimeve të deritanishme një grup italianësh të cilët po lundronin në ujërat e lumit Buna kanë arritur që t'i gjejnë dy predhat duke përdorur magnet. Është e paqartë se si grupi i italianëve kanë arritur që t'i gjejnë por menjëherë pasi kanë konstatuar dy predhat kanë lajmëruar policinë vendore të Shkodrës. Efektivët menjëherë kanë mbërritur në vendin e ngjarjes duke bllokuar kalimin e qytetarëve në urën e vjetër të bunës për të shmangur çdo lloj rreziku.

Është ende e paqartë se cilës periudhë i përkasin dy predhat por dyshohet se mund të kenë shumë vite. Një prej predhave është e përmasave të mëdha ndërsa tjetra është pak më e vogël. Tashmë pritet ardhja e forcave XHENIO nga Tirana për të bërë të mundur demontimin e tyre. Gjetja e dy predhave në ujërat e lumit Buna gjatë paradites së sotme ka tërhequr vëmendjen e qytetarëve që qëlluan rastësisht aty. Kjo nuk është hera e parë që në zona të ndryshme të qarkut Shkodër gjenden predha të përmasave dhe kohrave të ndryshme.

Ka patur raste që këto vite janë gjetur predha edhe të luftës së dytë botërore ashtu siç shumë të tjera kanë mbetur nga viti i mbrapshtë 1997 kur Shqipëria pësoi thujase një luftë civile dhe depot e armëve u shpërthyen duke marrë në mënyrë të pakontrolluar mes të tjerave dhe qindra predha në mbarë Shqipërinë. Një pjesë janë gjetur në mënyra rastësore si kjo e sotmja ndërsa mendohet se shumë të tjera vijojnë të jenë në lumenj, liqene apo edhe të groposura rrëze kodrave e maleve të ndryshme apo edhe tunele nëntokësore në gjithë vendin të lëna në harresë. Gjithnjë ky lloj municioni është një rrezik për rata qytetarë të cilët i gjejnë sepse mundësia e shpërthimit të tyre është jo e vogël.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: lumi Buna magnet predha Shkoder URA

TË NGJASHME

Kultivoi kanabis në pronën e tij, arrestohet 34-vjeçari në Shkodër

11 Shtator, 2021

Sekuestrohet kanabis dhe kokainë, 4 të arrestuar në Shkodër (EMRAT)

10 Shtator, 2021


Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Aksident te "Rruga e Kavajës" në Tiranë, automjeti përplas biçikletën, 50-vjeçari dërgohet në spital

11 Shtator, 2021



Me kalë dhe sëpatë, arrestohet 54-vjeçari shqiptar në kufi, hyri në Greqi për të prerë lisa në pyll

11 Shtator, 2021



FOTO/ Operacion antidrogë në Greqi, kapen rreth 335 kg kanabis që vinte nga Shqipëria, në pranga një 51-vjeçar

11 Shtator, 2021

11 Shtator, 2021

Aksident me vdekje në Tiranë-Durrës, automjeti përplas këmbësorin, shoferi shoqërohet në komisarjat

11 Shtator, 2021

Gjyqtari liroi autorin e vrasjes në Fier, kreu i ILD: Ka nisur menjëherë vlerësimi i rastit, prej momentit të parë po ndjek raportimet për ngjarjen

11 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO

Basha mbledh Kolegjin e Kryetarëve të PD në rrethe. Mbështetjet vendimi i tij për përjashtimin e Berishës, vetëm dy kundër

11 Shtator, 2021

"130 milion euro tendera", denoncimi i PD: Skema e korrupsionit të Ramës e Ballukut me 7 tendera në Unazën e Tiranës

11 Shtator, 2021

U vra nga ish-burri, 23-vjeçarja kishte urdhër mbrojtjeje deri në tetor. Si u ndryshua masa për mjekim të detyruar nga gjyqtari i përfolur. Babai mori përsipër...

11 Shtator, 2021

Ministri i Punëve të Jashtme të Arabisë Saudite: Shqipëria është një partner kyç bashkëpunimi, jemi shumë të angazhuar në marrëdhënien e dy vendeve

11 Shtator, 2021

Presidenti Meta nuk humb kohë, dekreton Edi Ramën Kryeministër për të tretën herë

11 Shtator, 2021

VIDEO/ I veshur me xhup dhe i fshehur në një zonë rurale, shihni momentin e arrestimit të 31-vjeçarit që vrau ish-gruan në Fier

11 Shtator, 2021